
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo  Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	--	--

<b>Datë/a:</b>	20.11.2020
<b>Për/ Za/ To:</b>	“RAF IISHPK”
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 17.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Raf II SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit, me Numër të Prokurimit: 616 19 9686 511 nxjerr:

## V E N D I M

- 1.REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ” Raf IISHPK” e dates 12.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: 616 19 9686 511 , kundër Vendimit te AK -së, të datës 12.11.2020.
- 2.Autoriteti Kontraktues, vendos qe te vazhdoj aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: 616 19 9686 511 “sipas Njoftimit te dates 12.11.2020.
- 3.Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 20.11.2020 ka shqyrtuar kërkesën e OE-ik “Raf II SHPK” dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:  
 -Pretendimi i parë është pjeserisht i bazuar pasi që duke analizuar dëshmitë e dorëzuara për stafin kam konstatuar se pervoja e nje inxhinieri (inxh.i elektros)nuk eshte aqe sa eshte kerkuar,mirepo edhe gjate vleresimit e edhe tani komisioni profesional ka konstauar se ajo paraqet devijim te vogel dhe se i njejt ploteson kriterin tjeter-deshmite e menaxhimit te se paku dy kontratave te ngjajshme. Ne fazen e rivleresimit paraprak i eshte kerkuar edhe diploma

e bachelorit dhe e ka dorezuar, dhe bazuar ne kete komisioni profesional e ka trajtuar si tender te pergjegjshem;


-Lidhur me pretendimin tjeter per skadimin e regjistrimit te automjetit ju njoftoj se kerkesa e AK-se nuk e ka percaktuar kete dhe kjo mund te kerkohej si sqarim ne baze te nenit 72 te LPP-ik; dhe

-Pretendimi lidhur me mungesen e dy certifikatave eshte plotesisht i pa bazuar pasi qe keto dy certifikata jane eliminuar si kerkesa ne baze te njoftimit per korigjimin e gabimeve dhe nuk duhet te dorezohen nga asnje tenderues.

**Bazuar në sqarimet paraprake u vendos si në dispozitiv të Vendimit.**

**Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me Vendimin mund të parashtroj ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit në afat prej dhjetë(10)ditëve nga dita e pranimet të këtij Vendimi.**

Udhëheqësi i Prokurimit



(Zekë Bardhaj)